



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 26.2.2020

Përgjigjja e Prokurorisë së Përgjithshme mbi informacionin e kërkuar nga trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me procedime penale të regjistruara në emër të shtetasve ***,*** dhe ***,***.

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në postën elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 24.2.2020, është përcjellë nga KPA-ja përgjigjja e Prokurorisë së Përgjithshme mbi informacionin e kërkuar nga trupi gjykues i Kolegjit, në kuadër të gjykimit të çështjes që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Adnan Kosova, lidhur me procedime penale të regjistruara në emër të shtetasve ***,*** dhe ***,***.

Komisioneri Publik, pasi u njoh në seancën e kaluar gjyqësore me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, mban këtë qëndrim:

Nga rrethanat e shpjeguara nga subjekti i rivlerësimit krijohet bindja e padijenisë për faktin e përfshirjes së kushërinjve të tij në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar. Gjithashtu, sikurse konfirmojnë përgjigjet e dhëna nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, me juridiksion të përgjithshëm, për shtetasit ***,*** dhe ***,***, nuk ka pasur dhe nuk ka procedime penale të regjistruara në ngarkim të tyre apo urdhra të regjistrimit të emrave si persona të cilëve u atribuohet kryerja e ndonjë vepre penale.

KOMISIONERI PUBLIK

DARJEL SINA